



VENDIM

Nr. 97, Datë 17.06.2016

MBI

**MIRATIMIN E LICENSËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.06.2016, mbasi shqyrtoi draft – licensën dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punes, per miratimin e licensës së tregtimit të energjisë elektrike,

Vendosi:

1. Të miratojë licensën për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. (bashkëlidhur)
2. Efektet e kësaj license për subjektet e licensuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licensën aktuale.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI